

EKSTRAKT NGA INTERVISTA

[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 16 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]

Narratorja: Ma shumë ajo çika mixhës mirrët po kaniherë thom, “A e vete çfarë njeri osht’?” Ose, “A ka me nejt qaty?” Ose diçka, se me shku te ni shpi te ni njeri që s’e ngje munët me të qëllu tylifare. Edhe jena dy femra tek e fundit a din, nuk kena fuqi nashta m’u mbrojt nëse dikush munët me të sulmu ose diçka. Gjithmonë vjen edhe ajo tjetra ose kaniherë edhe burrin e shtin me fol në emën ton. Ose vjen, kur kish kohë na çojke, kontaktojke me to që me ditë, a din, që osht’ edhe ni mashkull me neve se veç na femrat osht’ pak problem. Zakonisht shkojna vet ose diçka kur të na thirrin femrat, si femën a din, ka plot qishtu prej jashtit që vijnë edhe ma shumë femrat mirrën me këto punë.

A normal osht’ tremë e frikë se ti nuk e dinë në banesë të kujna po hin ose çka munët m’u konë ose çka munët me të ndodhë qaty. Edhe nuk osht’ lehtë ka tjetra anë siguria, se për shembull ti në katin e tetë në dritare ki m’i fshi dritaret, përjasht ki m’u zgat, niherë munësh m’u konë e lodhtë ose me t’u mirrë mentë edhe munësh me ra poshtë. S’kena kurrfarë sigurie, a din, domethonë edhe pse punë shumë të rrezikshme nuk i bojna. Ni sen që e shohim që o pak ma zor kaniherë thojna, “Ma mirë p’e lojna se për 20 euro, nuk bon me shku jeta”.